




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



AKT NORMATIV

Nr. 26, datë 22.6.2021

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.137/2020,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2021 është:

Të ardhurat	489 526	milione lekë;
Shpenzimet	610 069	milione lekë;
Deficiti	120 543	milione lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2021 është

Të ardhurat	362 745	milione lekë;
Shpenzimet	483 288	milione lekë;
Deficiti	120 543	milione lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2021 është:

Të ardhurat	57 840	milione lekë;
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 450	milione lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	8 150	milione lekë;
- transferta specifike për emergjencat civile	564	milione lekë
- transfertë specifike për Bashkinë Tiranë	900	milione lekë
- Të ardhura të tjera	29 776	milione lekë;
Shpenzimet	57 840	milione lekë.
...		

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej,	46 136	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	14 084	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	32 052	milione lekë;
Shpenzimet	46 136	milione lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 10 700 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura, nga i cili, 200 milionë lekë përdoret për rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi prej 1 miliard lekësh mbetet në dispozicion të fondit rezervë për koston e vaksinave. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga fondi rezervë i sigurimeve të kujdesit shëndetësor përdoren 2 000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.”.

Neni 2

Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër sesa deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja, prej 150 408 milionë lekësh. Brenda këtij kufiri të huamarrjes totale neto përfshihet edhe emetimi i mundshëm i një eurobondi me vlerë indikative prej 61 890 milionë

lekësh. Ky kufi i huamarrjes totale neto mund të tejkalohet vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 20, të këtij ligji.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, është rreth 100 508 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë vijon:

- Eurobond 61 890 milionë lekë;
- Huamarrje afatgjata të destinuara për projekte me vlerë rreth 24 178 milionë lekë;
- Huamarrje në formë “mbështetjeje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 55 330 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth - 40 890 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milionë lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit që mbahet në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen “ - shpenzime të buxhetit qendror ...” shifra 459 940 milionë lekë” zëvendësohet me “... 469 788 milionë lekë”.
2. Në nënndarjen “ – Fondi rezervë i buxhetit ...” shifra “... 6 000 milionë lekë” zëvendësohet me “... 8 000 milionë lekë”.
3. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, zëvendësohen me tabelat 4 dhe 1, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, numri i punonjësve bëhet "... 83 764 ...".
2. Tabela nr.2, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 6

Neni 14 ndryshohet, më poshtë si vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë prej 9 000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për:

- raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 8 000 milionë lekë;
- përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, në masën 1 000 milionë lekë.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 500 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 7

Ne nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në buxhetin e Bashkisë Tiranë shtohet, si transfertë specifike, fondi prej 900 milionë lekësh, për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar.”.

2. Tabela nr.3, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 8

Neni 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2021, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 161 913 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj deri në 150 408 milionë lekë;
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 11 505 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 386 751 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 325 634 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 60 318 milionë lekë;
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 800 milionë lekë.”.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ